

## Programi i STREHËS për Terapi

Programi i STREHËS për terapi të pjesëmarrësve është i fokusuar në vlerat që kemi në tabelë, siq janë: **Sinqeriteti, Durimi, Bindja/Dëgjueshmëria, Vetkontrolli, Diciplina, Besnikëria/Besueshmëria, Respekti, Bashkëpunimi**. Në bazë të kësaj, **STREHA** përpilon këtë:

### RREGULLORE

#### Muaj 1-6

1. **Muaji i Parë**, 5 cigare në ditë.
2. Pas muajit të **parë**, 3 cigare në ditë deri atëherë kur pjesëmarrësi vet ka dëshirë ta lë duhanin. Duhani duhet të **sigurohet nga vet** pjesëmarrësi.
3. Prej muajit të **dytë**, një telefonatë në çdo dy javë me familjarët.
4. Pas **katër muajve**, çdo javë nga një telefonatë me familjarët.
5. Telefonata e parë nuk do të thotë që pjesëmarrësi ka të drejtë që fiks pas një muaji ta bëjë telefonatën. Kjo mund të jetë **1 muaj + 1 javë** apo **1 muaj + 10 ditë**. Kjo bëhet varësisht sipas arritjeve në terapi nga vet pjesëmarrësi dhe bashkëveprimi me kujdestarin personal përkatës. Telefonata bëhet në prani të kujdestarit personal deri në muajin e katër.
6. Pas **katër muajve**, **ekziston mundësia**, që pjesëmarrësit i lejohet vizita e parë nga familjarët, pastaj vizita mund të bëhet një herë në muaj, çdo muaj. Vizita varet prej sjelljes dhe kontributit të pjesëmarrësit. Një vizitë e tillë lejohet vetëm në pajtim me kujdestarin dhe stafin.

#### Muaji 7-9

1. Prap fokusi është tek vlerat e lartëcekura: **Sinqeriteti, Durimi, Bindja/Dëgjueshmëria, Vetkontrolli, Diciplina, Besnikëria/Besueshmëria, Respekti edhe Bashkëpunimi**. Nëse një pjesëmarrës i përmbushë dhe ju përmbahet vlerave të lartëcekura, **ekziston mundësia** të dal në qytet një herë në muaj. Dalja është e realizueshme vetëm nëse vlerohet pozitivisht dhe aprovohet nga kujdestari personal dhe stafi i STREHËS. Çdo dalje bëhet pas darkës.
2. Dalja në qytet, **nëse një pjesëmarrës i përmbushë dhe ju përmbahet vlerave të lartëcekura**, bëhet me dikë nga stafi apo një pjesëmarrës tjetër i cili qëndron në STREHË për më shumë se 10 muaj dhe stafi i STREHËS e vleron besnik, të sinqertë dhe të besueshëm.
3. Dalja në qytet realizohen me bicikletë apo në këmbë, kuptohet, **nëse një pjesëmarrës i përmbushë dhe ju përmbahet vlerave të lartëcekura**. Pjesëmarrësi ka mundësi edhe të organizoj një taksë të cilin ai paguan me paratë ditore që fiton në STREHË.
4. Daljet në qytet, **nëse një pjesëmarrës i përmbushë dhe ju përmbahet vlerave të lartëcekura**, realizohen në mbrëmje pas darkës, nga e hëna deri të premten, dhe jo në ditë të vikendit.

5. Pjesëmarrësit i takojnë **50 cent** në ditë, nga e hëna deri të premtën, pra, 5 ditë në javë si shpërblim për të arriturat e tij dhe si shpërblim për kontributin e dhënë në STREHË. Këto para ka mundësi që edhe të ndërpriten nga ana e stafit STREHA, në raste të **mos-përbushjes dhe mos-përmbajtjes të vlerave të lartëcekura**, rrespektivisht veprimeve në kundërshtim me programin e caktuar nga STREHA.
6. Pjesëmarrësi daljet në qytet, **nëse i përmbushë dhe ju përmbahet vlerave të lartëcekura**, i financon vet, me paratë që i fiton në STREHË. Po ashtu edhe cigaret.
7. Paratë për cigare, apo paratë shtesë, për pjesëmarrësit në STREHË nuk pranohen nga familjarët përveç nëse pjesëmarrësi ka nevojë për mjek apo dentist.

### **Muaj 10-12**

1. Pjesëmarrësi tani ka **1€ në ditë**, nga e hëna deri të premtën, pra, 5 ditë në javë.
2. Dalja në qytet i lejohet dy herë në muaj pa përcjelljes, **nëse një pjesëmarrës i përmbushë dhe ju përmbahet vlerave të lartëcekura**, respektivisht, në qoftë se vleresohet besnik dhe i besueshëm nga kujdestari personal dhe stafi i Strehës.
3. Tani pjesëmarrësi është përgjegjës që gjërat e higjenes personale t'i financoj vet me paratë e fituara nga puna dhe kontributi i dhënë në STREHË. Me këto para, pjesëmarrësi që tani i ka fituar, ka mundësi të blejë gjërat si: Mp3 vetëm, **nëse një pjesëmarrës i përmbushë dhe ju përmbahet vlerave të lartëcekura**.
4. Kur pjesëmarrësi ka një Mp3, përdorimi i tij lejohet vetëm në dhomën e vet.
5. Çdo blerje, paraprakisht, diskutohet me kujdestarin personal dhe se gjërat që blihen janë absolutisht personale dhe **nuk lejohen të ndahen** me pjesëmarrësit e tjerë dhe as **nuk lejohen të huazohen** nga një pjesëmarrës tjetër.
6. Në rast se ka keqpërdorime me këto lloj gjërash, atëherë ato konfiskohen nga stafi dhe paratë dhe dalja në qytet mund ndërprehen për një kohë të caktuar.
7. Në raste se ka keqpërdorime të daljeve në qytet, si sjellja jo adekuate apo përdorimi i subsancave të palejuara, dajlet ndërprehen në mënyrë të menjëhershme për një kohë të caktuar nga ana e stafit.

### **Muaj 13-?**

1. Pjesëmarrësi vazhdon sikur në muajt **10-12**. Mirëpo pjesëmarrësi tani çdo muaj ka një të diele të lirë ku mund të shfrytëzoj sipas dëshires se vet që e ka caktuar në pajtim me programin e STREHËS.
2. Pika të tjera të lirisë dhe të drejtat, e një pjesëmarrësi, tani në mënyrë individuale varen sipas **zvillimit personal në terapi** dhe kontributit e dhënë të pjesëmarrësit në STREHË.

- 
- A. Për të arritur lirinë e daljes në qytet apo paratë ditore, pjesëmarrësi vlerësohet në bazë të arritjeve të veta të bazuara në **vlerat e lartëcekura**. Në qoftë se pjesëmarrësi **nuk ka të arritura**, liria e daljes nuk i takon dhe i shtyhen derisa stafi vlerëson që ka përmirësime.
  - B. Çdo kundërshtim me programin e caktuar nga STREHA dhe ndaj rregullave të shtëpisë, ndëshkohen me heqjen e parasë ditore, telefonatave, cigareve dhe daljeve në qytet.
  - C. Për çdo blerje që pjesëmarrësi bënë duhet ta dëshmoj me një **kupon fiskal** tek stafi i STREHËS. Në rast se pjesëmarrësi, një blerje të tillë, nuk e dëshmon me kupon fiskal, paratë ditore ndërprehen për po atë shumë sa është vlera e blerjes për të cilën nuk ka kupon fiskal.
  - D. Çdo pjesëmarrës ka një libër të arkës ku regjistrohen të hyrat dhe të dalat që ka.
  - E. Pjesëmarrësit nuk i lejohet që ëmbëlsira apo pije prej qytetit t'i sjellin në STREHË. Gjërat që blihen, kur pjesëmarrësi del në qytet, konsumohen jashtë STREHËS.
  - F. Numri i cigareve që një pjesëmarrës do të tymos gjithmonë caktohet në fillim të muajit dhe pastaj nuk ka ndryshim gjatë gjithë muajit përkatës. Pjesëmarrësi nuk ka mundësi me caktu sasinë e cigareve për tymosje, përveç nëse dëshiron ta zvoqëtoj apo ta ndërpres atë plotësisht. Maksimumi janë 3 cigare në ditë dhe koha dhe tymosjes është **7:30, 12:30 dhe 18:30**. Cigaret nuk lejohen që pjesëmarrësit t'i tymosin bashkë. Tymosja bëhet një nga një tek vendi i caktuar dhe se cigarja tymoset në këmbë dhe jo ulur.
  - G. Çdo blerje e gjërave shtesë si p.sh. **Mp3** apo gjëra tjera të nevojshme, që bashkëbisedohen paraprakisht me kujdestarin personal, financohen me paratë personale që pjesëmarrësi i fiton në STREHË. Paratë prej familjarve lejohen vetëm **6 muajt e parë** për cigare dhe më vonë vetëm për gjëra si mjeku, dentisti apo syzat.
  - H. Cigaret lejohen vetëm nga paqeta. Duhani i hapur, ku pjesëmarrësi mbështjellë cigaret vet, kurrsesi nuk lejohet. Huazimi i cigareve prej një pjesëmarrësi tjetër është e ndaluar.
  - I. **Kur njëri nga pjesëmarrësit ka veprime në kundërshtim me programin e STREHËS, si psh "pirja tinëz e cigares", si pasoj të gjitha meritat që pjesëmarrësit i kanë arritë (cigaret, paratë ditore, daljet në qytet, vizitat familjare, telefonatat) për të gjithë pjesëmarrësit ndërprehen derisa qështja të zgjidhet dhe të pranohet gabimi me pretim që në të ardhmen një gjë e tillë në STREHË nuk do të ndodhë.**

**Me mirkuptim,  
STREHA**